

Qyteti im

falas

Çelet Konkursi Ndërkombëtar për qendrën e qytetit
100 - vjet Klubi sportiv "Skënderbeu"
Ditët e Korçës në Tiranë

"Kangjella, traditë që vazhdon"



**KORÇA KU
DUA TE JETOJ**



Shpallet Konkursi Ndërkombëtar

Korçë



Bashkia e Korçës shpalli Konkursin Ndërkombëtar të Projektit Studimi i Qendrës së Qytetit.

Kjo zonë është cilësuar prej saj si hapësira kryesore publike e grumbullimeve masive për të gjithë Korçarët, një objekt parësor për turistët, dhe një vend historik për qytetin.

Studimi i Qendrës së qytetit është pjesë e përpjekjeve të Bashkisë për të zbukuruar dhe restauruar hapësirat publike, për të kultivuar një

kuptim të ri të krenarisë qytetare tek korçarët dhe për të frymëzuar gjeneratën pasardhëse për ta zhvilluar më tej këtë qytet. Konkursi Ndërkombëtar synon të përftojë një projekt urban të detajuar për Studimin e e Qendrës së qytetit, i cili do të udhëheqë Bashkinë e Korçës në realizimin e vizionit të saj për qytetin.

ombëtar për qendrën e qytetit

sa së shpejti me një profil të ri urban



● Faza e dytë

Në garë 5 studio ndërkombëtare

Pas shpalljes së Konkursit Ndërkombëtar për Projektin e Studimit të Qendrës së Qytetit të Korçës, 12 studio prestigjioze ndërkombëtare hynë në garë duke prezantuar vizionin e tyre për qendrën e qytetit. Vetëm pesë prej këtyre studiove u përzgjedhën nga juria e parakualifikimit për të vazhduar konkurimin. Studiots pjesëmarrëse janë:

Balles Willson – Gjermani, Joubert Architecture – Hollandë, Daniel Libeskind – Sh.B.A, Domus Concept – Portugali, 51N4E- Belgjike.

Me përfaqësuesit e këtyre studiove, ditën e hënë, në datën 25 maj, u zhvilluan në Bashkinë Korçë një seri takimesh konsultative e informuese. Pas turit dhe njohjes me qytetin, ata ngritën pyetjet e tyre dhe morën përgjigje nga special-

istët e Bashkisë Korçë si dhe nga konsulentët e kontraktuar nga Bashkia.

Në fillim të muajit korrik do të zhvillohet konkursi, ku të pesë këto studio do të paraqesin projektet e tyre të masterplanit të qendrës.

Në fund, një juri ndërkombëtare do të shpallë vetëm një fitues, i cili do të kontraktohet nga Bashkia për të detajuar e për të përfunduar të gjithë masterplanin e qytetit të Korçës. Studimi i Qendrës së qytetit është pjesë e përpjekjeve të Bashkisë për të hijeshuar dhe rivalizuar hapësirat publike në qytetin tonë, duke kultivuar krenarinë qytetare e për t'i dhënë një tjetër sharm e një impuls ndryshe zhvillimit të qytetit të Korçës. Bashkia ka kërkuar që projektet e studiove fituese të jenë të realizueshme maksimalisht brenda 20 viteve të ardhshme.



Investimet në infrastruk



Një investim i rëndësishëm i Bashkisë Korçë i ka ndryshuar pamjen Lagjeve 1 e 2 të qytetit. 22 milion lekë nga Buxheti i Bashkisë Korçë kanë bërë të mundur zgjerimin, asfaltimin, ndërtim trotuaresh dhe ndricimin në Rrugën "Kongresi i Përmetit" si dhe asfaltimin e tre rrugeve të tjera, Teni Konomi, Pandeli Cale, Foqion Postoli, të cilat lidhin këtë rrugë me Bul. "Republika".

Paralelisht me këtë investim të Bashkisë, u krye edhe asfaltimi i rrugëve Dhimitraq Rrëmbeci, Stefan Andrea dhe Bardhyl Pojani nga fondi i Ujësllës.

Këto investime jo vetëm kanë përmirësuar ndjeshëm infrastrukurën e kësaj pjese të rëndësishme të qytetit, por ndihmojnë edhe në lehtësimin e trafikut në qytet.

Investimi në Shëtitoren "Fan Noli" të qytetit po kryhet me të ardhurat e Bashkisë me shumën 4 milion lekë.

Ndërhyrja për sistemimin dhe asfaltimin në këtë aks mjaft të rëndësishëm të qytetit është integruar me punën për rrjetin e kanalizimeve, i cili po kryet nga Ndërmarrja e Ujësllës- Kanalizimeve.

Shumë shpejt Bashkia do të ndërhyjë edhe në lulishten që shtrihet përgjatë kësaj rruge, duke bërë rigjenerimin total të kësaj sipërfaqe të gjelbër, e cila është një pjesë e rëndësishme e qytetit.

Strukturën e qytetit VAZHDOJNË



Përfundoi shtrirja e sistemit të kanalizimeve në Lagjen 11 të qytetit dhe po punohet me rritmet e duhura në Lagjen 12



Pas shtrirjes së rrjetit të kanalizimeve në Unazën e qytetit menjëherë filloi puna për asfaltimin në dy segmente të saj



Bulevard "Gjergj Kastrioti" ka marrë një pamje të re. Pas përfundimit të rrjetit të kanalizimeve, Bul. Gjergj Kastrioti u rivesh me tapet mjaft cilësor.

→ Bashkia Mbështetje dhe kontroll për biznesin

Finalizohet YEP- Inkurajimi i sipërmarrësve të rinj

Qytetit i shtohen 10 biznese të reja Internet Kafe, Design dhe Printime, Studio Fotografike, Farmaci Bujqësore, Berberanë, Sipërmarrje Ndërtimi, Bar kafe etj. 10 të rinjtë që hartuan planet më të mira të biznesit u shpallën fitues të grantit prej 130 000 Lek dhe përfitues të incentivave fiskale nga Bashkia e qytetit (tarifë regjistrimi 0 dhe 30% ulje në taksën vendore).

Ky është rezultati final i projektit YEP, zbatuar nga Bashkia Korçë, në kuadrin e programit “Qyteti mbështet të rinjtë”.

Projekti përfshiu 55 të rinj punëkërkuës, të cilët u trajnuan duke u përgatitur për t'u përballur me sfidat aktuale të tregut të punës, duke nxitur iniciativat sipërmarrëse. 14 prej tyre sot janë punësuar apo janë duke kryer praktikant profesional në institucione dhe biznese të ndryshme në qytet. Pjesa tjetër e të rinjve janë regjistruar pranë Zyrrave të Punësimit në pritje të shanseve të afërta shumë të mira për punësim.

Në vazhdim do të llobohet vazhdimisht në rrjetin e ngritur të bizneseve lokale për punësimin e të gjithë të rinjve pjesëmarrës si dhe do t'u ofrohet konsulencë e vazhdueshme bizneseve të sapoçelura.

● **Projekti u implementua nga Bashkia Korçë në bashkëpunim me CAAP- Aksione të Përbashkëta Kundër Varfërisë si dhe u mbështet nga USAID.**

● Pulla e liçensimit

Orientojmë qytetarin drejt produktit të kontrolluar

Subjekte të biznesit të vogël në qytetin e Korçës janë pajisur nga Bashkia e qytetit me pullën e sigurisë.

Pajisja e subjekteve me pullën e liçensimit është një proces joformal dhe mjaft i rëndësishëm pasi e ndihmon bashkinë të identifikojë subjektet që operojnë në mënyrë të ndershme në treg dhe qytetarin të orientohet drejt produktit të sigurt dhe të kontrolluar.

Nga ana tjetër, Bashkia Korçë në bashkëpunim me Shoqatën e Biznesit të Vogël dhe Agjensinë rajonale të Zhvillimit po punojnë për vendosjen e orareve të tregëtimit dhe përcaktimin e ditës së pushimit.



Policia Bashkiake autoritet për vendparkimet në qytet

**KUSH SHKEL RREGULLAT,
PAGUAN!**



Qytetarë më
të përgjegjshëm



I nderuar drejtues automjeti!

Policia Bashkiake ka detyrimin ligjor të kontrollojë shkeljen e rregullave të parkimit të automjeteve në qytet.

**KUJDES
PARKIMIN!**




KUJDES!!! PARKIMIN

www.bashkiakorce.gov.al



Do të konsiderohen shkelje dhe do të ndëshkohen:

- Parkimi mbi trotuar
- Parkimi në stacionet e autobusëve urbanë dhe taksive
- Parkimi i dyfishtë "disaminutësh" (në krah të vendqëndrimeve të lejuara)
- Parkimi në krah të kontenierëve të mbeturinave
- Parkimi në kundërshtim me sinjalet rrugore

Për çdo rast, orientohuni nëpërmjet  sinjalistikës rrugore!

Ndëshkimi i parashikuar në ligj dënohet:

- Gjobë nga 500 lekë deri në 2 000 lekë
- Blikim automjeti me një pajisje të veçantë ose dërgim i mjetit në pikën e blikimit

Për ç'do problem që do të hasni, mos nguroni të paraqiteni pranë sportelit të Informimit ose të njoftoni në nr e telefonit: 2 457 55 dhe 2 432 49



Fond i veçantë për Shoqërinë Civile dhe angazhimin qytetar

Bashkia e Korçës ve në dispozicion të Shoqërisë Civile një fond të posaçëm duke u bërë e vetmja Bashki në Shqipëri, e cila ndërmerr një hap të ri me qëllim angazhimin e Shoqërisë Civile.

Fondi është krijuar falë angazhimit të Bashkisë Korçë, Këshillit Bashkiak, të mbështetur nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Republika Federale e Gjermanisë. Me objektivin kryesor mbështetjen e grupeve me bazë komuniteti, OJF dhe qytetarë aktivë, ky fond synon të kthehet në një mjet për të përmirësuar pjesëmarrjen qytetare me nisma dhe aktivitete konkrete dhe në një mundësi për qytetarët e Korçës që të bëhen më aktivë dhe të kontribuojnë në progresin e komunitetit.

Në takim ishin të pranishëm edhe Ambasadori i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri Robert Boch, i cili është njëkohësisht edhe iniciatori i krijimit të këtij fondi, si edhe përfaqësuesi i Ambasadës Gjermane në Shqipëri Bernard Dresbah. Marrëveshja u nënshkrua nga Kryetari i Bashkisë së Korçës Niko Peleshi dhe Menaxherja e Qendrës së Zhvillimit të Shoqërisë Civile në Korçë CSDC Erea dra Taipllari.

Korça parapërgatit fillim

...ju sjellim pak Korçë



Në qendër të Tiranës, Korça prezanton produktet dhe profilin festiv

Me qindra qytetarë korçarë që banojnë në Tiranë, artistë, politikanë, biznesmenë etj, u bënë për dy net me rradhë pjesë e panairit festiv në qendër të Tiranës së bashku edhe me shumë vizitorë të rastësishëm vendas e të huaj.

Veç stendave të panairit ku u shitën dhe u promovuan produktet më të mira të rajonit, festa solli Korçën me të gjithë elementet e traditës së saj: karnavalet, serenatat, festat dhe sharmin e qytetit pa dyshim më të spikatur

në kulturë e tradita në Shqipëri. Të pranishmit kanë shijuar birrën, kërnacet, serenatat, karaoken deri pas mesnate në një festë të veçantë dhe të bukur. Për vizitorërt dhe të interesuarit e shumtë u shpërndane guidat e qytetit, Kalendari i Eventeve i publikuar për të dytin vit rradhazi nga Bashkia Korçë.

Ky aktivitet i veçantë, i pari i këtij lloji në Shqipëri u organizua nga GTZ dhe Bashkia Korçë, me mbështetjen e SNV dhe Dhomës së Tregëtisë dhe Industrisë Korçë.

min e Sezonit Turistik

Bashkia Korçë publikon EVENTS CALENDAR

2009

Ka kohë që qyteti juglindor përmendet vazhdimisht për gjallërinë dhe atmosferën festive që po u dhuron qytetarëve të vet dhe turistëve të rastësishëm, ose jo.

Publikimi i “Kalendarit të Aktiviteteve”, i pari i këtij lloji në Shqipëri, për të dytin vit rradhazi, liston me ambicie një mori aktivitete kulturore, festash dhe panairesh përgjatë periudhës Mars-Dhjetor 2009.

Dëshira për t’i dhënë vendin që meriton Korçës, entuziazmi me të cilin qytetarët korçarë kanë pritur të gjitha aktivitetet si edhe rritja e numrit të turistëve nga dita në ditë, kanë nxitur bashkinë e qytetit të punojë me përkushtim për t’i dhënë Korçës imazhin e një qyteti që gjallërohet nga dita në ditë. E ku tjetër mund të kaloni fundjava të paharrueshme, përveçse në Korçë, në qytetin që këndon, kërcen, shijon birrë, dëfrehet, admiron një pikturë, duartroket në koncert, ngrin në aparat ato që duhet të mbeten përgjithmonë, në qytetin që thjesht i pëlqen të jetojë dhe të ndihet...

Në kalendar duhet të shënoni datat kur në Korçë nuk duhet të mungoni. “Festa e birrës”, “Festa e Lakrorit”, “Java e kulturës”, “Karnavalet”, “Kolonja e Skulptorëve”, “Panairi i fundvitit”, janë vetëm disa nga aktivitetet e këtij viti.

Ky është qyteti, që të gjithë duhet ta vizitoni!

Ky është Qyteti i Festave!

Mirësevini në Korçë!



Korça, qyteti ku do

Ata nuk kanë lindur në Korçë madje as në Shqipëri, por kësaj qyteti i kanë bërë bukuri dhe mikpritës duke u ingranuar shumë mirë me një Korça është qyteti ku me dëshirë do të kthehen përsëri pa...

Katerina Cici

“Ndjem me fat që punova në Korçën e kulturës”

Ka lindur në Greqi. Studimet e larta i ka mbaruar në Suedi, në Universitetin e “Forskollarlinje” në Stokholm. Është specializuar për një vit në Suedi në fushën “Edukim për të rritur” dhe më pas ka punuar tre vjet atje, si mësuese.

Pas kësaj eksperience u kthye në Greqi ku ushtroi profesionin e mesueses në qytetet e Korintit, Edesës, Selanikut dhe tani punon në Korçë si mësuese në shkollën greke “Omios”.

Katerina tregon fillimet e punës së saj në Korçë :

Si çdo fillim edhe fillimi i punës në Korçë ishte i vështirë, sepse më mungonin shumë gjera: familja, fëmijët e mi, vendlindja, miqtë, të afërmit, gjuha etj. Nuk më mungonte pasioni për profesionin, respekti dhe mirënjohja për ata qindra e mijëra shqipëtarë që punonin tek ne në Greqi. Në fillim të viteve '90 kam njohur shumë shqiptarë që vinin për të punuar, disa edhe janë strehuar në shtëpinë time në Edessa, kam njohur edhe fëmijë 14 – 15 vjeçarë, atëherë sa mosha e djalit tim që punonin shume, me dhimbsheshin, i desha dhe i ndihmoja pa e ditur se edhe une do të vijja një ditë në atdheun e tyre...

Vështirësitë nuk zgjatën shumë sepse në shkollë gjeta kolegë dashamirës, bashkëpunues, që më mirëkuptonin e më mbështesnin si kolegja Marianthi Vrame që ishte kolegja e parë me të cilën bashkëpunuam.

Këtu gjeta njerëz miqësorë, të hapur, të cilët sapo merrnin vesh që unë isha greke fillonin të më tregonin për kohën kur kishin qenë në Greqi, ose për miqtë e tyre që punojnë e studiojnë atje. Bisedonim si miq, ata me

“greqishten” e tyre dhe unë me “shqipen” time.

Tani unë kuptoj dhe flas mirë shqip dhe ka shumë arsye që ende më motivojnë për ta përsosur gjuhën shqipe.

Tani kam shumë miq në Korçë, me të cilët dua të flas shqip, sepse jam në Shqipëri, por veç kësaj kam dëshirë të shikoj TV në shqip, të lexoj poetët korçarë si: Rusi, Merdani etj. Kam lexuar edhe Ismail Kadarene në greqisht “Bija e Agamemnonit” ndërsa tani po e rilexoj në shqip. Tingëllon bukur. Gjuha juaj është e mrekullueshme...

Çfarë i ka pëlqyer Katerinës në Korçë ?

Më pëlqejnë shumë gjëra që më bëjnë të ndihem si në shtëpinë time, më pëlqen që qytetarët korçarë bashkëjetojnë në paqe pavarësisht nga besimi fetar.

Më pëlqejnë nikoqiret korçare, oborret me lule, serenatat, por mbi të gjitha më bën përshtypje kultura korçare.

Kam pasur rastin të ndjek disa veprimtari me muzike klasike në Qendrën e Kulturës “Vangjush Mio” dhe aty nuk mungojnë edhe qytetarë të moshuar, gjë që tregon traditën e qytetit, gjë që rallë mund të ndodhë në Greqi.

Më pëlqejnë piktorët korçarë; Ristani, Kuqali, Xega, Kallço, këngëtarët dhe aktorët. Korça është qyteti i kulturës.

Në Korçë më pëlqejnë shtëpitë e vjetra karakteristike që dëshmojnë historinë e qytetit, por pezmatohem kur shoh aty – ketu shtëpi të braktisura që po rrenohen, dritare të mbyllura dhe ndonjë kortinkë e harruar...

Them: “Ku janë këta njerëz? Kur do të vijnë në vendin e tyre, të punojnë për të, e ta zbukurojnë?”

Më pëlqejnë festat që aq bukur i organizon Bashkia e qytetit, dekori i qytetit për Krishtlindje, më pëlqen motoja e punës së Bashkisë “Korça qyteti ku dua të jetoj”, ndërsa unë do të thosha: “Korça, qyteti ku do të rikthehem sërish”

Faleminderit revistës suaj që më dha mundësi të flas për Korçën.



të rikthehem sërish!

kanë zgjedhur të jetojnë e të punojnë në këtë qytet të
erëzitet dhe jetën këtu. Nëse i pyet, të thonë pa hezitim se
si është kthyer në pjesë të jetës së tyre.

Gianna Pierdomenico

Korrespondente konsullore e Ambasadës Italiane në Shqipëri
Mësuese e gjuhës italiane në Shkollën "Faik Konica" Korçë

Korça, një qytet i rëndësishëm për kulturën shqiptare

Ishte korriku i vitit 2005 kur mora emërimin nga Ministria e Punëve të Jashtme Italiane për të ardhur në Shqipëri dhe pikërisht në qytetin e Korçës. Ishte hera e parë që do të largohesha nga qyteti im dhe do të shkoja në një qytet të panjohur, ashtu si dhe vetë Shqipëria. Nuk prisja ndonjë gjë të madhe, por nuk kisha as paragjykim. Ishte një pritje, për më tepër me efekte pozitive për të zbuluar një popull që ka pasur një histori, politikë sociale dhe ekonomike të ndryshme nga vendet e tjera të Ballkanit. Kisha disa mundësi zgjedhjeje, por zgjedha qytetin tuaj, Korçën mes tre qyteteve të tjerë ku kemi seksionet tona dygjuhëshe. Dëshiroja të provoja një përvojë krejt ndryshe 360 gradëshe duke shmangur qytete të cilat mund të ishin tepër komode për ne perëndimorët: Bratislava, Londra etj. Me thenë të drejtën, diçka kisha dëgjuar për vendin tuaj në shkollën ku jepja mësim në Friuli, pasi mes nxënësve italianë kishte dhe shqiptarë që na tregonin për sakrificat që kishin bërë për të mbërritur në Itali. Por informacione kishim edhe përmes televizorit menjëherë pas viteve '90. Sapo mora vesh për emërimin tim në Korçë, bëra një udhëtim njohës më parë. Ky ishte udhëtimi im i parë në Shqipëri. Më pëlqeu qyteti juaj, shumë. Më pas mbërrita për të kryer detyrën time si mësuese në shkollën e Gjuhëve të huaja në Korçë. Do të kishim kohë të gjatë para për të njohur nga afër këtë qytet shumë të rëndësishëm për kulturën shqiptare.

Përshlypjet fillestare referuar vështirësive të fillimit kryesisht në infrastrukturë si mungesa e dritave apo ngadalësia e internetit, më krijuan idenë e një vendi ku nuk mund të jetohej lehtë. Ndërsa për

çudinë time tek korçarët vizioni ishte tepër optimist dhe duhet të theksoj se interesi dhe dashuria për italianët ishte befasuese. Në bisedat e para që pata ata më shpjeguan se shqiptarët janë shumë të përzemët me të huajt. Mikpritja është një fakt shumë domethënës, një vlerë e mirëfilltë. Unë zgjedha të jetoja e të punoja në Korçë me shumë dëshirë. Ndjehesha mirë, jo vetëm prej mikpritjes por edhe prej vlerave të këtij qyteti dhe banorëve të tij.

Gianna tregon aspekte te punes të saj në Korçë:

Në Korçë që nga ditët kur fillova punë në shkollën F.Konica krahas të tjerave fillova të interesohem edhe për nevojat e Shtëpisë së fëmijës duke sjellë ndihma jo vetëm personale, por edhe nga miq dhe dashamirës të tjerë italianë. Ndihma sollën edhe kolegë dhe nxënës nga qytete italiane dhe kulmoi me ardhjen edhe të europarlamentares italiane Katiusha Marini. Për herë të parë praktikua teatrin në shkollë duke vënë në skenë në bashkëpunim edhe me teatrin e Korçës pjesë të autorëve italianë. Duke qënë pjesë e Ambasadës italiane kryeva detyrën edhe të koordinatores dhe prej dy vitesh jam Korrespondente Konsullore. Në liceun dygjuhësh kemi praktikuar arkeologji eksperimentale, laboratorë duke bashkëpunuar edhe me shkollat të tjera të qytetit dhe më gjerë në Shqipëri. Bashkë me kolegë kemi organizuar çdo vit Javën e gjuhës italiane në botë dhe kjo solli bashkëpunime edhe me Universitetin e Korçës. Nxënësit tanë kanë marrë pjesë në konkurse të ndryshme në Itali dhe ne kemi punuar që këta nxënës të shkojnë në Itali për të marrë pjesë në dhënie e çmimeve. Bashkëpunimi ka qënë i frytshëm edhe me institucionet shqiptare si Bashkia e Prefektura. Kanë dhënë sfaqje në Korçë aktorë dhe instrumentistë italianë gjatë këtyre viteve. Me Ambasadën organizuam Konferencën shkencore në Universitetin vitin e kaluar dhe këtë vit ditët e orientimit për studentët shqiptarë. Ndihma jonë u shtri edhe për familje dhe fëmijë në nevojë të qytetit duke dërguar për kurim qytetarë të Korçës në Itali. Sivjet në sajë të një bashkëpunimi realizuam edhe një muze etnografik duke sjellë tarditat shqiptare të dasmës. Të gjitha këto punë më kanë dhënë një kënaqësi të madhe për sa kohë janë bërë edhe me dashuri të madhe.



Vështrim në Kohë

Korça, 100 vjet sport



100 vjet më parë, në një qytet si Korça do të kishim lindjen e sportit modern shqiptar. Kanë qenë shkodrani i njohur Hil Mosi, së bashku me atdhetarë të tjerë të këtij qyteti të cilët krijuan shoqërinë e parë Kulturoro-sportive “Vllazëria”. Ishte prilli i vitit 1909 dhe Mosi që në ato vite u mësonte të rinjve Edukatën Fizike, së bashku me figura të njohura të këtij qyteti të kësaj periudhe, vendosën bashkërisht edhe me pëlqimin e të gjitha shoqërive të tjera që të formonin vetëm një shoqëri e cila mori emrin “Shoqëria Sportive Vllazëria” e cila mban datën 15 prill të vitit 1909. Gjatë këtyre viteve sportistët korçarë do do të shkonin deri në nivelet më të larta të sportit edhe botëror. Mjafton të thuash se për aq sa Kasati dhe atletët e tij ishin në pistë, i sollën vendit tonë 65 medalje ndërkombëtare që nga ajo e Pavlina Evros në mitingun e Nicës e deri tek titujt e shumë ballkanikë të garave të thellësive e kroseve të shumta. Kasati me atlete të tilla si Evro, Menkshi e Hanxhara, e ngjitet

atletikën shqiptare në podet më të larta të garave europiane e ballkanike, gjë e cila nuk kishte ndodhur më parë. Edhe sot pas kaq vitesh, për të shkuar në nivelin e këtyre atleteve, atletikës sonë për fatin jo të mirë i duhen shumë vite. Në këtë 100- vjetor, në sportet individuale duhen përmendur emrat e Artur Krekës e Arben Zhamos në mundje klasike, ashtu siç duhen thënë fjalët më të mira për alpinistët P Janaqi e Koço Ziso, Lame Nika e Koço Qafzezi, të cilët nuk kanë lënë majë mali në vendin tonë pa pushtuar. Skënderbeu ka patur edhe qitës kampionë mes të cilëve Miril Qano ka vendin kryesor në klubin korçar, ashtu siç kanë në ski, Rako Zguri e Jonel Ndoci për meshkuj e Sofika Zguri për femra, për ta mbyllur me një shahist si Artur Muçollari.

Nga Tonin Frroku

Hani i Manastirit

Monument kulture i shpallur në vitin 1973



Hanet zenë një vend të rëndësishëm në strukturën e pazarit të Korçës. Mbahen mend 16 hane, ndërsa në ditët e sotme vijnë në gjendjen e parë ose të transformuar 9 prej tyre. Hani i Manastirit ashtu si edhe pjesa më e madhe e haneve të tjerë, njihet për nga klientela dhe jo nga emri i pronarit.

Hani i Manastirit e ka hyrjen kryesore në sheshin qendror të pazarit. Ai është ndërtuar në një periudhë të mëvonshme, pranë Hanit të Elbasanit, dhe si i tillë ka sjellë të reja si në teknikë ashtu edhe në material ndërtimi.

Rreth oborrit të brendshëm katror, gjatë katër brinjëve të tij ngrihen ndërtime dykatëshe. Në të dy krahët e hyrjes kryesore janë shkallët, të cilat të çojnë në katin e dytë, nga të cilat njëra është prej druri ndërsa tjetra prej guri. Ato përfundojnë në galerinë që i shkon përreth ndërtimeve dhe ndërlidh odat e fjetjes të rreshtuara gjatë saj. Galeria është e mbyllur me vitrina të

mëdha në tre krahë, të cilat me hapësirat e tyre të mëdha dhe të ndara në kolona të holla druri, e ruajnë përshtypjen e galerisë së hapur. Krahu ballor është në një nivel më të lartë se tre të tjerët dhe ruan një trajtim të ndryshëm nga pjesa tjetër; në oborr janë hapur dritare në vend të xhamllëqeve gjë që dëshmon se ky krah është rindërtuar në një fazë të mëvonshme. Ky ndryshim kompozicional që vihet re tek Hani i Manastirit tregon që ai manifeston të reja e kohës, të cilat pasqyrohen edhe në konceptet e reja funksionale. Kështu, është krijuar një komoditet më i madh për bujtësit dhe një ndarje e qartë funksionale e dhomave të fjetjes nga stallat e kafshëve, të cilat janë vendosur në pjesën e mbrapme të hanit.



Materialet kryesore të përdorura janë guri në katin përdhe dhe tulla në katin e sipërm. Muret ndarës janë ndërtuar me teknikën e çatmasë, ndërkohë që përpunimi zbukurimor është i përbajtur. Kati i sipërm është i gjallëruar me dritare të shumta dhe një ballkon i dalë në pjesën qndrore. i dekoruar me shufra hekuri.

Dita Ndërkombëtare e Jetimëve



Fizioterapistët amerikanë, vizita falas për fëmijët e Korçës

Bashkia e Korçës për të dytin vit mundësoi ardhjen e mjekëve fizioterapistë në qytetin e Korçës, duke bashkëpunuar me Universitetin Utica College –SHBA.

Në datat 23 dhe 24 maj, në ambientet e Spitalit Pediatrik, dy fizioterapistët amerikanë, Dale Scalise-Smith dhe Mary Jean Gelsomino me eksperiencë në fushën e ekzaminimeve dhe trajtimeve të kësaj fushe, ofruan shërbimin e tyre për fëmijët prematurë, atletë të dëmtuar, fëmijë me sëmundje muskulare dhe në kocka, dëmtime traumatike, shërbime për fëmijë që hasin vështirësi në mbajtjen e ekuilibrit dhe ecje etj. Prindërit e fëmijëve asistuan gjatë ekzaminimit duke marrë sugjerime për ushtrime dhe aktivitete të mëtejshme.

Ju qëndrojmë pranë

Më 20 Maj, Ditën Ndërkombëtare të Jetimëve, Bashkia e qytetit të Korçës ua përkushtoi fëmijëve jetimë të qytetit.

Në orët e para të mëngjesit, Kryebashkiaku Niko Peleshi vizitoi 14 fëmijët e Shtëpisë së Foshnjës duke u dhuruar atyre lodra për këndin e lojrave dhe duke përcjellë njëkohësisht mesazhin për kujdesin e vazhdueshëm të Bashkisë Korçë për këta fëmijë edhe nëpërmjet projekteve të shumëllojshme sociale që po zbatohen nëpërmjet Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Më tej në orët e pasdites, 50 fëmijë jetimë, në bashkëpunim me dy organizata, Shoqatën e Fëmijëve Jetimë dhe organizatën rome Amaro Drom, u argëtuan tek Bar "Richi", një kënd ky mjaft të preferuar për fëmijët, i cili ishte tërësisht në dispozicion të festës e tyre. Të gjithë fëmijëve të pranishëm Kryetari Peleshi u dhuroi nga një libër, i cili përcjell mesazhin për të qëndruar sa më pranë tij, sa më pranë bankave të shkollës si të gjithë fëmijët e tjerë.





Konkursi Ndërkombëtar “Sotir” në edicionin e 2-të

Në garë, fotografë të rinj nga e gjithë bota

U zhvillua me sukses në Korçë, edicioni i dytë i Konkursit Ndërkombëtar për fotografë të rinj nën titullin e fotografit të madh korçar “Sotir”. Pas suksesit të një viti më parë, rezultat i bashkëpunimit mes Bashkisë Korçë, Qendrës Kulturore Lindart & Anima/ Projekt 5.6, këtë vit prurjet e fotografëve të rinj të ardhur nga e gjithë bota, shënuan një hop mjaft cilësor. “Një prekje dhune” ishte përzgjedhur për këtë vit koncepti i ekspozitës, që u pasqyrua në të gjithë dimensionin e saj nga konkurentët, me imazhe të thella në përmbajtjen e tyre, duke fshehur dhunën, e cila nuk shihet por ndihet. Në këtë konkurs morën pjesë 67 fotografë të rinj, prej të cilëve u përzgjedhën punimet e 14 prej tyre, artistë të rinj, fotografë nga 11 vende të ndryshme të botës. Kryetari i Bashkisë së Korçës Niko Peleshi në ceremoninë e ndarjes së çmimeve, e vlerësoi Konkursin Ndërkombëtar “Sotir”, si një mesazh për të gjithë ata që kanë një fjalë për të thënë apo mundësi për t’i dhënë kulturës së qytetit tonë. Çmimi i parë i jurisë ndërkombëtare të Konkursit “Sotir” i u dha fotografit nga Singapori Zhao Renhui me ciklin e titulluar: “Më shumë mund të kemi të gjithë bashkë”. Ndërsa çmimi i dytë, ka shkuar për të riun shqiptar Arjan Vyshka, me cikin e fotografive: “Shtëpi mjerimi”.

Korça e projektuar në fotografi në tre panele diskutimi

Arkitektura e Korçës në fotografi - **nga Maks Velo**

Vlerat e qytetarisë korçare - **nga Ben Blushi**

Arti dhe vlerat artistike të Korçës në fotografi - **nga Natasha Lako**



Spektakli rinor “Rin Show”

Për të dytin vit rradhazi Bashkia Korçë, Teatri “Andon Zako Çajupi” në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale Arsimore organizuan “Rin Shoë”. Të rinjtë e talentuar, nxënësit të shkollave të mesme të qytetit të Korçës, shpalosën talentet e tyre në një maratonë artistike 8 ditore në skenën e teatrit profesionist të qytetit. “Rin Shoë” evidentoi dhe iu hapri rrugë talenteve të rinj, të cilët performuan në fushat e aktrimit, këngës, sfilimit dhe prezantimit. Të rinjtë, krahas përcjelljes së vlerave artistike, hodhën edhe mesazhe të qarta për bashkëmoshatarët e tyre “jo drogës”, “jo alkolit”, “jo duhanit”. Ata u vlerësuan me çmime nga një juri profesionistësh e ngritur për këtë qëllim. Për këtë vit, fituese u shpall Shkolla e Mesme e Përgjithshme “Themistokli Gërmenji”. Iniciativa e Bashkisë së qytetit për kthimin në traditë të një aktiviteti të tillë, synon evidentimin e talenteve të reja, përfshirjen e të rinjve në aktivitete kulturore dhe mbajtjen gjallë të kësaj tradite të bukur për qytetin e artit.



Ne jemi pjesë e Tokës

Nxënësit e shkollave 9-vjeçare u bënë protagonistë në Ditën Ndërkombëtare të Tokës, në datën 22 Prill.

Mesazhin “Ne jemi pjesë e Tokës” nxënësit e përcollën me punimet e tyre nga materiale të riciklueshme, nëpërmjet një ekspozitë – konkurs të hapur në Bibliotekën “Thimi Mitko” të qytetit.

Nxënësit, gjatë ekspozimit prezantuan punimet e tyre, të cilat nënvizonin idenë se të gjithë së bashku mund të kontribuojmë në ruajtjen e Tokës sonë dhe në mbrojtjen e mjedisit përreth. Juria e ngritur me përfaqësues nga institucione të ndryshme, vlerësoi angazhimin e nxënësve në këtë projekt, fantazinë, tematikën e zgjedhur dhe mesazhet që përcollën. Shkolla më e mirë e vitit 2009 është shpallur “Sevasti Qiriazhi”, e cila përveç dhuratave dhe çertifikatës, ka marrë edhe globin simbolin e kësaj dite, i cili do të qëndrojë për një vit në ambientet e kësaj shkolle.



Është i dyti vit që ky aktivitet organizohet nga Bashkia Korçë, me mbështetjen e Drejtorisë Arsimore Rajonale, Korsel Sh.p.k, Sife, Federatës së Paqes Universale, Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike etj.

Çelet Panairi i Poçerisë “Korça 2009”



Për të dytin vit, Bashkia Korçë organizoi Panairin e Poçerisë, i cili është pjesë e Programit “Shpirti i Traditës”. Në këtë panair, u thirrën për të marrë pjesë të gjithë artizanët e rajonit të Korçës, një pjesë e të cilëve ekspozuan dhe tregëtuan produktet e traditës në baltë e qeramikë. Përgjatë këtyre ditëve, veçanërisht në orët e mbrëmjes, sheshi i panairit gjallëroi nga qytetarë të Korçës dhe turistë vendas e të huaj. Produktet e

shumëllojshme, i krijuan qytetarit mundësi të shumta zgjedheje sipas shijeve e preferancave të gjithsecilit. Sipas traditës, të gjithë blejnë një objekt zbukurimi prej balte. Nëpërmjet kësaj feste, Bashkia synon stimulimin e artizanatit të poçerisë, një traditë e hershme e qytetit tonë, të cilën Bashkia e qytetit kërkon ta rikthejë, duke i ofruar qytetarit korçar por edhe turistëve produktin e traditës. Panairi qëndroi i hapur gjatë gjithë javës.

Festivali Koral European në Korçë, traditë dhe emocione

Për të tretin vit me rradhë, në datat 8 e 9 maj, u mbajt në Korçë Festivali Koral European, një eveniment i rëndësishëm kulturor jo vetëm për qytetin e Korçës.

Publiku elitër, ndoqi 6 grupe korale, nga Shqipëria, Kosova, Greqia, Italia, Kroacia e Gjermania, të cilët prezantuan për audiencën korçare, këngë të klasikëve më të mëdhenj botërorë po aq sa edhe muzikën moderne, por edhe këngë të muzikës tradicionale të vendeve respektive, duke prezantuar dhe shkëmbyer në këtë mënyrë vlerat e kulturës dhe të civilizimit të vendeve europiane. Grupet sollën një origjinalitet interpretimesh duke spikatur për cilësi të lartë artistike ndaj dhe morën duartrokitjet e ngrohta të publikut.

Shqipëria u prezantua në këtë festival koral Kori “Lyra”, nën drejtimin e Jorgaq Nanos, Artist i Merituar, i cili bëri hapjen e këtij festivali. Më pas kanë vijuar programin e tyre Okteti Plus i Kosovës, grupi më i ri dhe simpatik i krijuar në vitin 2005 i drejtuar nga Ylber Asllanaj, për ta mbylluar ditën e parë me grupin koral nga Greqia “Mixed Choir of Thesaloniki” nën drejtimin e Mary Konstantinidou.

Dita e dytë e festivalit u hap me Korin italian “Mezzotono” për të vijuar me dy grupet e fundit korale “Zenska Klapa Fortuna” nga Kroacia nën drejtimin e Maja Marusic dhe më pas “Voices in time” nga Gjermania të drejtuar nga Stefan Kalmer.

Ky festival u zhvillua në sallën e Katedrales “Ringjallja e Krishtit”, ku Bashkia e qytetit të Korçës u bë partnere mbështetëse e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Komisionit European që organizuan dhe mbështetën këtë eveniment artistik.



“Pranverë 2009” – Ekspozita e përvitshme e artistëve figurativë korçarë

Ashtu siç është bërë tashmë traditë në prag pranvere, edhe këtë vit, artistët figurativë korçarë vijnë me një ekspozitë të përbashkët. Me mbështetjen e Bashkisë Korçë dhe të Qendrës Kulturore “Vangjush Mio” të qytetit, ekspozita u çel në Galerinë “Guri Madhi”. Në të u ekspozuan 50 punime në pikturë nga 20 autorë jo vetëm nga Korça por edhe nga Pogradeci dhe Erseka.

Mbizotëruan kryesisht peisazhi dhe natyra e qetë, por nuk munguan edhe kompozime e prirje surrealiste si dhe teknikat e reja kryesisht nga piktorët e rinj në moshë, veprat e të cilëve iu bashkëngjitën kësaj ekspozite.



Korça i jep dramaturgut rumun Ion Caramitru medaljen “Emblema e artë e qytetit”

Personaliteti i dramaturgjisë botërore Ion Caramitru, artisti dhe veprimtari i shquar rumun me origjinë nga Korça, vlerësohet medaljen “Emblema e artë e qytetit” nga Këshilli Bashkiak i Korçës, qytetit të tij të origjinës, me motivacionin: “Si mirënjohje për vlerat e larta humane dhe artistike që ai përfaqëson”.

I emocionuar nga pritja e ngrohtë e rezervuar në Bashkinë e qytetit dhe në veçanti për titullin e akorduar, z. Caramitru falenderoi Këshillin Bashkiak si dhe Bashkinë Korçë e në veçanti Kryetarin e saj Niko Peleshi. Artisti i madh është shprehur se Korça ka lënë gjurmë të thella në kujtesën dhe ndërgjegjen e tij humane dhe artistike.



Vallevdekje, drama që përcolli mesazhe të forta për jetën

Vallevdekje titullohet drama e shkruar nga August Strindberg, e cila u vu në skenë nga trupa e teatrit “A.Z.Çajupi” me pjesëmarrjen e aktorit të njohur të Teatrit Kombëtar Alfred Trebicka.

Mesazhin e veprës e ka firmosur autori me fjalët:

... a është jeta punë serioze apo vetëm një farsë?
Në qoftë se është thjesht shaka,
atëherë mund të kthehet në shaka shumë të hidhur.
Kurse serioz, njeriu ia kalon qetë-qetë dhe rehat...

Korça –një peisazh plot ngjyra në penelin e piktorit lezhjan Pashk Përvathi

Ditën e mërkurë, në datën 15 prill, tek Galeria “Guri Madhi”, piktori i njohur lezhjan Pashk Përvathi, i nderuar me Urdhërin: “Naim Frashëri”, çeli ekspozitën e tij vetjake, të mundësuar nga Bashkia Korçë dhe Qendra Kulturore “V.Mio”.



Kjo është ekspozita e parë e një piktori jokorçar, e cila në qendër të të gjithë pikturave të saj ka Korçën, bukuritë natyrore dhe arkitektonike të saj. Në prezantimin e ekspozitës së tij, piktori Përvathi nënvizoi se frymëzimi i parë për të, kanë qenë veprat e Mios së madh dhe më pas, bukuritë e rajonit të Korçës.

Koncert me vepra të autorëve shqiptarë

Trioja Zhuljeta Sheremeni –soprano, Ilia Lulo – flaut, Entela Kotelli –piano, në datën 15 prill, ora 18.00, në sallën e koncerteve të Qendrës Kulturore “V.Mio” dhanë një koncert me veprat e autorëve shqiptarë Ç.Zadeja, F.Ibrahimi, P.Kurti, A.Mula, P. Jakova e T.Dajja.



Ceremonia e dhënies së titujve në 100 –vjetorin e sportit korçar

Vepimtaritë me rastin e 100-vjetorit të krijimit të Shoqërisë së Parë Kulturoro-Sportive “Vllazëria” në qytetin e Korçës kulmuan ditën e premte, në datën 15 maj, me ceremoninë e dhënies së titujve “Qytetar Nderi” dhe “Emblema e Artë” në Teatrin “A.Z.Çajupi” të qytetit.

Në sallën e teatrit, krahas përfaqësuesve të pushtetit lokal e atij qëndror si dhe drejtuesve të sportit korçar, ishin të pranishëm elita e sportistëve korçarë ndër vite, ku 5 më të mirët e këtyre 100 viteve u ngjiten në skenë për të marrë titullin e lartë “Qytetar Nderi” dhe 28 të tjerë titullin “Emblema e Artë” të akorduara nga Këshilli i Bashkisë Korçë.

Përgjegjësja e Klubit Shumësportësh Tatjana Marash ka treguar shkurt historinë 100-vjeçare të një sporti të mbushur me figura të shquara, të cilët kanë nderuar emrin e sportit shqiptar duke vjelë trofe kombëtare e ndërkombëtare.

Për Kryetarin e Bashkisë së Korçës Niko Peleshi, i cili përshëndeti këtë eveniment historik për qytetin tonë, arritjet e sportit korçar gjatë këtyre viteve, tregojnë për një traditë mjaft të spikatur e cila të bën të ndihesh krenar.

-Dhënia e titujve nga Këshilli i Bashkisë së Korçës, është shprehje e vlerësimit dhe mirënjohjes që qyteti ka për të gjithë ata që japin kontribut, -ka përfunduar fjalën e tij përshëndetëse z.Peleshi.

Njëkohësisht, Presidenti i Republikës Bamir Topi, akordoi Titujt “Naim Frashëri i Artë” për Shoqërinë sportive “Vllazëria”, dhe veteranin e sportit Thomaq Spaho, i cili u dorëzua nga Këshilltari i tij Maksim Cikuli.



Me rastin e 100-vjetorit të klubit sportiv “Vllazëria”, disa institucione dhe Shoqëria Civile në Korçë janë ndeshur mes tyre në dy disiplina, volejboll për femra dhe futboll për meshkuj. Në volejboll morën pjesë gjashtë ekipe, prej të cilave kupën e meritoi ekipi i Drejtorisë Arsimore Rajonale.

Edhe në ndeshjet e futbollit ku morën pjesë nëntë ekipe, vendin e parë e meritoi ekipi i Drejtorisë Arsimore Rajonale, ndërsa ekipi i Bashkisë Korçë u rendit në vendin e dytë.

Nderohen me “Qytetar Nderi” 5 sportistët më të mirë ndër vite



Për herë të parë, listës së Qytetarëve të Nderit të Korçës i shtohen emrat e 5 sportistëve korçarë.

Me rastin e 100 vjetorit të formimit të Shoqërisë së Parë Sportive “Vlazëria”, Këshilli Bashkiak i qytetit të Korçës miratoi dhënien e titujve “Qytetar Nderi” për 5 sportistët më të mirë ndër vite, të cilët i kanë dhënë emër sportit korçar e atij shqiptar në aktivitetet kombëtare e ndërkombëtare. Titulli i lartë “Qytetar Nderi” i’u dha (pas vdekjes) të parit mundës profesionist, modelit të sportistëve të rinj, Petro Sturgjit. Po me këtë titull, është nderuar futbollisti e trajneri Kristaq Bimli, i cili njihet si “babai” i futbollit korçar, për meritat e shquara në masivizimin e futbollit dhe kontributin e spikatur në lëvizjen olimpike. Është nderuar gjithashtu, gjimnasti Valter Meta, me merita të shquara në sportin e gjimnastikës, fitues i 16 Medaljeve të Arit, për të vazhduar me dy rekordmenet e atletikës, fitueset e Medaljeve të shumta të Arit nëpër botë, të cilësuarat si “shkolla” e atletikës korçare, Pavlina Evro dhe Anila Menkshi.

Krahas këtyre emrave, 26 sportistëve të tjerë, i’u dha medalja “Emblema e Artë e Qytetit”.



Panairi i Poçerisë



Përgatitën:

Ana Qeramixhi
Benila Tërova
Sofjola Kotelli
Mikel Llogori

Ndihmuan:

Stafi i Bashkisë Korçë
Pallati i Kulturës “V.Mio”
Ndërmarrja e Shërbimeve
Publike
Teatri “A.Z.Çajupi”
Klubi Shumësportësh
Gjergji Koki- designer

Fotot nga:

Ana Qeramixhi
Donald Braholli
Vaskë Niço
Studio “Xhimi”

Design:

R&T Advertising

Për një qytet ku bashkëjeton tradita me modernen, ku të rinjtë realizojnë aspiratat e tyre për shkollim dhe punësim, ku të moshuarit jetojnë ditë të bardha, një qytet që ka gjithmonë një dorë të zgjatur për të nxjerrë nga vështirësia dhe ku problemi yt gjen një zgjidhje.

Pas një kthese ecim me vrull në një drejtim të ri për të kapur kohën e humbur dhe për të dalë në krye siç i ka hije Korçës. Ky është identiteti ynë i ri.

Mbështesni “Qyteti Im”



Për më tepër informacion:

Tel: 082 245755

e-mail: qyteti.im@bashkiakorces.gov.al

bashkiko@albamail.com

www.bashkiakorces.gov.al